

DERMOLIFE ACADEMY

Shkolla e formimit profesional me
programe studimi 1 dhe 2 vjeçare



RRETH AKADEMISË

ÇDO PROFESION KA HISTORINË E TIJ

Disa lindin nga talenti, të tjerë nga përkushtimi. Por të gjithë kanë nevojë për një vend ku aftësitë zhvillohen dhe potenciali merr formë.

Dermolife Academy është krijuar për të përgatitur profesionistë në fusha që sot janë ndër më të kërkuarat në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar.

Programet tona kombinojnë **njohuritë teorike me praktikën profesionale**, duke i dhënë studentëve mundësinë të fitojnë eksperiencë reale gjatë procesit të studimit.

PSE FORMIMI PROFESIONAL?

Në vitet e fundit, tregu i punës kërkon njerëz që dinë të përshtaten dhe të sjellin zgjidhje konkrete.

Në **Dermolife Academy**, çdo program është i formuar për t'ju dhënë njohuri praktike, aftësi profesionale dhe vetëbesimin e nevojshëm për të hyrë në treg me siguri.



ÇFARË NA DALLON?

ÇERTIFIKATË NDËRKOMBËTARE

TRAJNIME INDIVIDUALE

ORARE FLEKSIBËL

PRAKTIKË PROFESIONALE

AMBIENTE MODERNE

MUNDËSI ZHVILLIMI PROFESIONAL EDHE PAS PËRFUNDIMIT TË STUDIMEVE.

PROGRAMET E STUDIMIT

01

ESTETIKË E AVANCUAR

Industria e estetikës është sot një nga sektorët me zhvillimin më të shpejtë në botë.

Por suksemi në këtë profesion nuk ndërtohet vetëm mbi pasionin. Ai kërkon njohuri, praktikë dhe përgatitje të vazhdueshme.

Në **Dermolife Academy**, programi i **Estetikës së Avancuar** është krijuar pikërisht për këtë qëllim: *të formojë profesionistë që e njohin shkencën e lëkurës po aq mirë sa artin e kujdesit ndaj saj.*

Çdo modul është ndërtuar për të kombinuar bazat teorike me praktikën profesionale, në mënyrë që studentët të fitojnë sigurinë dhe aftësitë e duhura për tregun e punës.

Për t'iu përshtatur objektivave dhe angazhimeve të secilit student, programet ofrohen në disa formate studimi:

2-VJEÇAR

FORMIM I PLOTË PROFESIONAL

1-VJEÇAR

FOKUS NË KOMPETENCAT KRYESORE TË PROFESIONIT

6-MUJOR

IDEAL PËR ATA QË DËSHIROJNË TË ZHVILLOJNË AFTËSI TË REJA PROFESIONALE NË DY DREJTIME TË ESTETIKËS SË AVANCUAR

3-MUJOR

NJË PROGRAM PRAKTIK DHE I PËRQENDRUAR NË NJË DREJTIM TË ESTETIKËS PËR TË FITUAR NJOHURITË BAZË NË NJË KOHË TË SHKURTËR



Gjatë studimeve, studentët njihen me *anatominë dhe fiziologjinë e lëkurës, higjienën dhe sigurinë profesionale, analizën e lëkurës, trajtimet estetike të fytyrës dhe trupit, përdorimin e teknologjive estetike, protokollet profesionale të punës, si edhe komunikimin dhe kujdesin ndaj klientit.*

Një nga pikat më të forta të programit është praktika profesionale. Studentët kanë mundësinë të ushtrojnë njohuritë e fituara në ambiente reale pune, duke zhvilluar aftësi praktike, vetëbesim dhe përvojë që i përgatit për sfidat e profesionit.

Ky program është i përshtatshëm si për ata që hedhin hapat e parë në industrinë e estetikës, ashtu edhe për profesionistët që dëshirojnë të përditësojnë njohuritë dhe të specializohen sipas kërkesave të tregut.



02

SPECIALIST I USHQYERJES PËR MIRËQENIE DHE SPORT

Mënyra se si ushqehemi ndikon në çdo aspekt të jetës sonë. Nga energjia që kemi gjatë ditës, te performanca fizike, përqëndrimi, rikuperimi i organizmit dhe parandalimi i shumë problemeve shëndetësore, ushqimi është kthyer në një nga shtyllat kryesore të mirëqenies.

Paralelisht me rritjen e ndërgjegjësimit për një stil jetese të shëndetshëm, është rritur edhe nevoja për profesionistë që dinë të udhëheqin, të këshillojnë dhe të edukojnë individët mbi rëndësinë e ushqyerjes së balancuar.

Programi 1-vjeçar “Specialist i Ushqyerjes për Mirëqenie dhe Sport” në Dermalife Academy është krijuar për të formuar profesionistë me njohuri të plota mbi bazat e nutricionit, fiziologjinë e organizmit dhe ndikimin që ushqyerja ka në shëndetin, mirëqenien dhe performancën fizike.

Procesi i të nxënies është konceptuar për të qenë praktik dhe i orientuar drejt situatave reale. Përmes studimeve të rasteve, ushtrimeve profesionale dhe diskutimeve me pedagogë të fushës, studentët zhvillojnë jo vetëm njohuri teorike, por edhe aftësinë për t'i zbatuar ato në praktikë me përgjegjësi dhe profesionalizëm.

KY PROGRAM ËSHTË NJË ZGJEDHJE IDEALE PËR TË RINJTË QË SYNOJNË TË NDËRTOJNË NJË KARRIERË NË FUSHËN E NUTRICIONIT DHE MIRËQENIES, PËR PROFESIONISTËT E SEKTORIT TË FITNESS-IT DHE WELLNESS-IT QË DËSHIROJNË TË ZGJEROJNË KOMPETENCAT E TYRE, SI EDHE PËR KËDO QË BESON SE EDUKIMI USHQIMOR ËSHTË NJË INVESTIM ME VLERË PËR INDIVIDIN DHE SHOQËRINË.

03

MENAXHIM BIZNESI

Çdo biznes fillon me një ide, por vetëm idetë e menaxhuara mirë arrijnë të rriten, të zhvillohen dhe të qëndrojnë konkurruese.

Në një treg që ndryshon vazhdimisht, nuk mjafton të kesh një produkt apo një shërbim të mirë; *duhet të dish të marrësh vendime, të organizosh burimet, të udhëheqësh njerëzit dhe të ndërtosh një strategji që i reziston kohës.*



Programi 6-mujor i Menaxhimit të Biznesit në Dermolife Academy është krijuar për të pajisur studentët me njohuritë dhe aftësitë praktike që kërkon bota e sipërmarrjes dhe administrimit modern. Programi u drejtohet jo vetëm atyre që ëndërrojnë të hapin biznesin e tyre, por edhe profesionistëve që dëshirojnë të avancojnë në karrierë, të marrin role drejtuese ose të kuptojnë më mirë mënyrën se si funksionon një biznes.

Gjatë programit, studentët njihen me parimet bazë të menaxhimit, organizimin e proceseve të punës, planifikimin strategjik, marketingun, komunikimin me klientin, administrimin e burimeve njerëzore dhe elementët kryesorë të financës së biznesit. Çdo temë trajtohet me një qasje praktike, duke u mbështetur në shembuj konkretë dhe situata reale që hasen çdo ditë në botën e biznesit.

Ky program është ideal për sipërmarrësit e rinj, administratorët e bizneseve të vogla dhe të mesme, profesionistët që synojnë pozicione menaxheriale, si edhe për çdo person që dëshiron të kuptojë më mirë mekanizmat që e bëjnë një biznes të suksesshëm.

04

GRAPHIC DESIGN

GRAPHIC DESIGN NUK ËSHTË
MË THJESHT NJË PROFESION KREATIV.

Është një nga aftësitë më të kërkuara nga bizneset, agjencitë e marketingut, kompanitë teknologjike dhe sipërmarrjet e çdo sektori. Çdo organizatë ka nevojë për identitet, dhe çdo identitet fillon me dizajnin.

Programi **6-mujor** i Graphic Design në Dermolife Academy është krijuar për të formuar profesionistë që dinë të komunikojnë ide përmes imazhit, duke kombinuar kreativitetin me njohuritë teknike dhe standardet e industrisë.

Gjatë programit, studentët mësojnë të *ndërtojnë materiale vizuale që nuk janë vetëm estetikisht të bukura, por edhe funksionale, strategjike dhe të orientuara drejt rezultateve.*



Proçesi i të nxënies nis me bazat e dizajnit grafik, teorinë e ngjyrave, kompozimin dhe ndërtimin e identitetit vizual. Më pas, studentët zhvillojnë aftësi në përdorimin e programeve profesionale të dizajnit, krijimin e logove, materialeve promociionale, përmbajtjes për rrjetet sociale, materialeve për print dhe komunikimit vizual.

Në përfundim të studimeve, çdo student ndërton një portofol profesional, elementin më të rëndësishëm për të hyrë në tregun e punës. Ky portofol pasqyron zhvillimin e aftësive, stilin krijues dhe projektet e realizuara gjatë programit, duke u kthyer në kartën e tij më të fortë të prezantimit për agjensi, kompani apo klientë.

05

WEB DESIGN

INTERNETI KA NDRYSHUAR MËNYRËN SE SI NJERËZIT BLEJNË, INFORMOHEN, KOMUNIKOJNË DHE ZGJEDHIN.

Rritja e biznesit online ka krijuar një kërkesë gjithnjë më të madhe për profesionistë që dinë të ndërtojnë faqe moderne, lehtësisht të navigueshme dhe të përshtatura me sjelljen e përdoruesve.

Web dizajnerët punojnë në agjenci marketingu, kompani të industrive të ndryshme ose si profesionistë të pavarur.

Programi **6-mujor i Web Design në Dermolife Academy** është krijuar për të formuar profesionistë që duan të hyjnë në botën digjitale me njohuri praktike dhe një bazë të qëndrueshme profesionale.

Gjatë këtij programi, studentët njihen me procesin e plotë të krijimit të një faqeje interneti, duke nisur nga koncepti fillestar dhe organizimi i strukturës, deri te ndërtimi i një projekti funksional. Përmes kombinimit të teorisë me praktikën, studentët do të mësojnë si të krijojnë faqe që janë jo vetëm vizualisht tërheqëse, por edhe të lehta për t'u përdorur dhe të përshtatura me kërkesat e tregut aktual.

Programi është i përshtatshëm për këdo që dëshiron të zhvillohet profesionalisht në teknologji dhe dizajn, si edhe për profesionistët që kërkojnë një aftësi të re në një industri që vazhdon të zgjerohet çdo ditë.

06

KUJDESTAR PËR FËMIJË

TË KUJDESESH PËR NJË FËMIJË DO TË THOTË TË JESH PJESË E NJË PREJ FAZAVE MË TË RËNDËSISHME TË JETËS SË TIJ.

Do të thotë të kuptosh nevojat e tij, të krijosh një ambient të sigurt dhe të dish kur një fëmijë ka nevojë për kujdes, për vëmendje apo thjesht për dikë që e dëgjon.

Profesioni i kujdestarit për fëmijë kërkon më shumë sesa dashuri për të vegjlit. Ai kërkon përgatitje, durim, përgjegjësi dhe njohuri mbi zhvillimin fizik, emocional dhe social të fëmijës.

Pas përfundimit të programit, kursantët janë të përgatitur për të ushtruar profesionin e kujdestarit në ambiente familjare, kopshte, qendra kujdesi apo struktura të tjera ku kërkohet kujdes profesional ndaj fëmijëve.



KUJDESTAR PËR TË MOSHUAR

TË KUJDESESH PËR NJË PERSON TË MOSHUAR KËRKON SHUMË MË TEPËR SESA DËSHIRËN PËR TË NDIHMUAR

Rritja e numrit të të moshuarve dhe nevoja për shërbime të specializuara kujdesi kanë rritur kërkesën për profesionistë të trajnuar në këtë fushë.

Programi **6-mujor “Kujdestar për të Moshuar”** në **Dermolife Academy** është krijuar për të pajisur studentët me njohuritë dhe aftësitë praktike që kërkon ky profesion. Gjatë këtij formimi, kursantët mësojnë si të ofrojnë shërbim të organizuar, duke kuptuar jo vetëm nevojat bazë të të moshuarit, por edhe rëndësinë e komunikimit, respektit dhe mbështetjes psikologjike.

Ky formim ju përgatit për mundësi punësimi në kujdesin individual në familje, në qendra rezidenciale për të moshuar, institucione dhe organizata që ofrojnë shërbime sociale, struktura private, etj.

Gjithashtu, njohuritë e marra gjatë programit mund të jenë një bazë e vlefshme për ata që dëshirojnë të punojnë në sektorin e kujdesit social, të zhvillojnë më tej kompetencat profesionale ose të krijojnë një shërbim të pavarur në këtë fushë.

Gjatë këtij formimi, studentët marrin njohuri mbi:

- Procesin e plakjes dhe ndryshimet fizike, psikologjike dhe sociale që shoqërojnë moshën e tretë.
- Organizimin e kujdesit të përditshëm, duke përfshirë higjienën personale, ushqyerjen, ndihmën në lëvizje dhe aktivitetet bazë të jetës së përditshme.
- Komunikimin profesional me të moshuarit dhe familjarët e tyre, duke kuptuar rëndësinë e empatisë, respektit dhe mbështetjes emocionale.
- Krijimin e një ambienti të sigurt për të parandaluar rrezikun dhe aksidentet në përditshmëri.
- Kujdesin ndaj personave me nevoja të veçanta dhe mënyrën e përshtatjes së shërbimit sipas gjendjes dhe kërkesave individuale.
- Organizimin e rutinave ditore që ndihmojnë në ruajtjen e mirëqenies dhe pavarësisë së të moshuarit.

NIS SOT RRUGËTIMIN TËND DREJT SUKSESIT

KY ËSHTË MOMENTI PËR TË INVESTUAR
NË TË ARDHMEN TËNDE

☎ +355 69 60 67 222

📷 @dermolife_academy

🌐 www.dermolife-academy.al

📍 Rr. "Petro Nini Luarasi",
Tirana, Albania

